



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 7.11.2022

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

(SHQYRTIMI NË PARIM)

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në 8 mbledhje, të zhvilluara në datat 26, 27 dhe 31 tetor, si dhe 1, 2, 3, 4 dhe 7 nëntor 2022, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat është komisioni përgjegjës për shqyrtimin e tij. Shqyrtimi i këtij projektligji bëhet sipas procedurave të përcaktuara në nenet 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë projektligj, znj. Blerina Gjylameti dhe znj. Enslemvera Zake.

Projektbuxheti, si çdo vit, u shqyrtua sipas një kalendari të posaçëm pune, të koordinuar me komisionet e tjera të Kuvendit. Komisioni shqyrtoi politikat dhe treguesit e përgjithshëm të projektbuxhetit, si dhe analizoi në detaj pjesët e veçanta të tij, si të ardhurat, shpenzimet, defiçitin buxhetor e borxhin publik.

Në të gjitha mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm Ministrja e Financave dhe drejtues të stafit të kësaj ministrie.

Në një mbledhje të posaçme, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me drejtuesit e Bankës së Shqipërisë, për të marrë opinionin e këtij institucioni mbi projektbuxhetin.

II. Baza ligjore.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin mbështetur në:

- Nenet 78, 83, pika 1 dhe 158 të Kushtetutës;
- Nenin 30 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

III. Kuadri i politikave mbi të cilat bazohet projektbuxheti 2023.

Politikat, treguesit dhe objektivat e projektbuxhetit 2023 mbështeten në:

- Kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm 2023-2025;
- Programin e Qeverisë;
- Politikat dhe prioritetet e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë;
- Ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore përkatëse etj.

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tri vitet në vijim. Ky dokument synon ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimin e klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimin sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Europian. Këto synime të kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm parashikohen të realizohen nëpërmjet zbatimit të disa objektivave, siç janë:

- Synimi i një trajektoreje rënëse të borxhit publik, duke targetuar si objektiv operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit prej vitit buxhetor 2024 dhe në vijim.
- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal çdo vit dhe, mundësisht, mbi nivelin 5 përqind të PBB mesatarisht çdo vit.
- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektiv themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 përqind në një periudhë afatmesme dhe ancorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmi i politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare.
- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, si dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këto objektiva themelore përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal, brenda të cilave përcaktohen projektionet e detajuara.

Politikat dhe treguesit e projektbuxhetit mbështeten në trendin e zhvillimit të ekonomisë së vendit në vite, zhvillimet dhe politikat ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme për vitin 2022, si dhe pritshmëritë për zhvillimin afatmesëm.

- *Projektbuxheti 2023 paraqitet si pjesë e PBA 2023-2025.*

Që prej vitit 2015, projektbuxheti vjetor paraqitet si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, duke përcaktuar dhe harmonizuar politikat, prioritetet dhe treguesit për vitin e ardhshëm me ato të periudhës afatmesme. Projektbuxheti 2023 paraqitet si pjesë e PBA 2023-2025, e cila pasqyron kufijtë maksimalë të shpenzimeve buxhetore për çdo ministri e institucion, të detajuar sipas programeve buxhetore për secilin prej viteve të periudhës afatmesme.

- *Projektbuxheti 2023 mbështetet në vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare.*

Projektbuxheti mban në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si Komisioni European, FMN e Banka Botërore, si dhe të agjencive ndërkombëtare që mbikëqyrin ekonominë e vendit tonë. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Komisioni European ka vlerësuar se Shqipëria ka bërë progres të mirë dhe është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. E mbështetur nga një tërësi politikash të përshtatshme, ekonomia shqiptare tregoi elasticitet dhe u rimëkëmb më shpejt se sa pritej në 2021, duke kompensuar shumicën e humbjeve ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka goditur ekonominë shqiptare në mënyrë indirekte, përmes çmimeve më të larta të mallrave dhe rritjes më të ulët në partnerët kryesorë tregtarë të BE-së, por nuk u përkthye në një ndikim negativ në rritjen gjatë tremujorit të parë të vitit 2022.

Deficiti buxhetor dhe raporti i borxhit publik u rritën më pak se sa ishte parashikuar në vitin 2021, Ka pasur progres të mirë në reformat e lidhura me të ardhurat.

Inflacioni është rritur mbi objektivin, gjë që e shtyu bankën qendrore të rrisë normën bazë në disa hapa. Mjedisi i biznesit përfitoi nga një nivel më i lartë i dixhitalizimit të shërbimeve publike.

Për vitin e ardhshëm, raporti i Komisionit European vendos disa objektiva, si:

- Me kusht që rimëkëmbja ekonomike të jetë e qëndrueshme, të parashikohet në planin fiskal afatmesëm një reduktim gradual i raportit të borxhit publik dhe i detyrimeve të prapambetura, duke përdorur procesin e rregullt legjislativ gjatë ndryshimit të buxhetit;
- Zbatimi i reformës së menaxhimit të investimeve publike;

- Të fillojë zbatimimi i strategjisë afatmesme të të ardhurave, pas konsultimit të gjerë publik dhe bazuar në një plan operacional.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar se, që prej vitit 2019, ekonomia shqiptare i ka përballuar goditjet e shumta relativisht mirë. Pas një rritjeje të lartë në vitin 2021, ekonomia shqiptare ka mbajtur një ritëm pozitiv në vitin 2022, pavarësisht goditjes nga lufta e Ruisë ndaj Ukrainës. Rritja ekonomike në vitin 2022 parashikohet 3.7 për qind, mbështetur nga një aktivitet i lartë në turizëm, pasuritë e paluajtshme dhe shërbimet. Rritja në 2023 parashikohet të jetë rreth 2 për qind, duke pasqyruar ngadalësimin e rritjes dhe kushtet financiare më të shtrënguara në Europë.

Inflacioni këtë vit është rritur, si rrjedhojë e rritjes së inflacionit të importuar. Ai do të fillojë uljen në vitin 2023 dhe do të kthehet në objektivin prej 3 për qind të Bankës së Shqipërisë nga mesi i vitit 2024.

Për të minimizuar risqet dhe për të ruajtur ritmin pozitiv të ekonomisë, është e nevojshme:

- Të vazhdojë konsolidimi fiskal, mbështetur në një Strategji të shëndoshë Afatmesme për të Ardhurat, për të krijuar hapësirë për manovrimin e politikës fiskale. Mbështetja buxhetore duhet të jetë e përkohshme dhe të orientohet tek shtresat në nevojë. Duhet të rritet efienca dhe besueshmëria e financave publike;
- Nevojitet shtrëngim i politikës monetare, për të zbutur inflacionin. Kjo politikë duhet të koordinohet me vigjilencën për ruajtjen e stabilitetit financiar;
- Duhet të rriten përpjekjet e institucioneve ndaj reformave strukturore, për të ngritur potencialin drejt një rritjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Banka Botërore ka vlerësuar se rritja ekonomike në vitin 2021 rezultoi më e fortë nga sa ishte parashikuar, nga politikat stimuluuese, si dhe rigjallërimi i sektorit të turizmit dhe ndërtimit. Rritja ekonomike në 6-mujorin e parë 2022 ishte 6 për qind, e nxitur nga konsumi privat, investimet dhe eksportet. Tregu i punës shënoi përmirësim dhe papunësia ra në 11.3 për qind.

Lufta që po zhvillohet në Ukrainë, me pasojat e saj në rritjen e shpejtë të çmimeve të energjisë dhe ngadalësimin e rritjes së ekonomisë botërore, pritet të kufizojnë ritmet e rritjes ekonomike të Shqipërisë dhe rajonit. Në periudhën afatmesme, ekonomia shqiptare pritet të rritet me ritme më të ngadalta, në nivele të ngjashme të rritjes me ato të para pandemisë.

Në përgjigje të rritjes së çmimeve të ushqimeve, qeveria ka shtuar alokimet buxhetore për mbështetjen e grupeve të cenueshme, të cilat aktualisht po përfitojnë edhe nga çmimet e subvencionuara të energjisë elektrike.

Politikat mbështetëse për shtresat e cenueshme duhet të vazhdojnë, për shmangjen e rreziqeve fiskale. Këto politika duhet të jenë të kufizuara në kohë.

Rëndësi ka edhe përshpejtimi i tranzicionit të gjelbër, për kalimin nga përdorimi i hidrokarbureve të paqëndrueshme, drejt prodhimit më të pastër të energjisë elektrike, si dhe drejt modeleve më të gjelbërta të prodhimit dhe konsumit.

IV. Opinioni i Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë paraqiti opinionin e këtij institucioni për projektbuxhetin e vitit 2023, si institucion i mandatuar për ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit, si dhe në rolin e këshilltarit financiar të qeverisë. Në opinionin e tij, Guvernatori analizoi çështjet e mëposhtme:

Së pari, kuadri makroekonomik dhe politika fiskale.

Situata e inflacionit të lartë, që po përjeton vendi ynë, është rrjedhojë e rritjes së madhe të çmimeve të ushqimeve, naftës, energjisë dhe lëndëve të para në tregjet botërore, e cila u transmetua në strukturën e kostove të prodhimit dhe pritjet e operatorëve për të ardhmen.

Në këto kushte, prioriteti kryesor i politikave ekonomike ka qenë dhe mbetet marrja e masave për garantimin e stabilitetit të çmimeve, për të siguruar stabilitetin ekonomik e financiar të vendit. Për këtë qëllim:

- Banka e Shqipërisë ka filluar normalizimin e qendrimit të politikës monetare, duke rritur gradualisht normën bazë të interesit;
- Politika fiskale ka vazhduar konsolidimin, përmes reduktimit të deficitit buxhetor dhe përmirësimit të balancës primare. Ky konsolidim do të japë efekte pozitive në ruajtjen e shëndetit afatgjatë të financave publike, reduktimin e nevojave për huamarrje të sektorit publik në tregun e brendshëm financiar dhe reduktimin e nevojës për normalizim të shpejtë e të fortë të politikës monetare.

Rritja ekonomike do të mbetet në territor pozitiv edhe gjatë viteve të ardhshme. Me gjithë ngadalësimin e ritmit në periudhën afatshkurtër, për shkak të ambientit të jashtëm sfidues, rritja ekonomike do të përshpejtohet në periudhën afatmesme dhe afatgjatë për shkak të reduktimit të inflacionit, rritjes së besimit të konsumatorëve dhe biznesit, si dhe stabilizimit të kushteve financiare.

Për këto arsye, Banka e Shqipërisë gjykon se kuadri makroekonomik i prashikuar në projektbuxhet është realist dhe konsistent si me trendet aktuale të zhvillimit të vendit, ashtu edhe me kahun e pritur të politikave monetare e fiskale.

Konsolidimi fiskal duhet të udhëhiqet nga rritja e të ardhurave. Shpenzimet korrente në afatin e shkurtër duhet të rriten në mënyrë të kontrolluar, për të mbështetur shtresat në nevojë nga rritja e inflacionit. Për të përballuar rreziqet e mundshme lidhur me rritjen ekonomike dhe realizimin e të ardhurave, është e nevojshme të shtohen fondet e kontigjencës në buxhet, të monitorohet në

vazhdimësi ecuria e sektorit energjitik, si dhe të monitorohet ecuria e realizimit të planit të të ardhurave dhe investimeve publike.

Së dyti, rritja e efektivitetit dhe ruajtja e fleksibilitetit të financave publike.

Guvernatori vlerësoi përpjekjet e qeverisë për rritjen e formalizimit të ekonomisë dhe paraqiti disa rekomandime për rritjen e efektivitetit të financave publike, si më poshtë:

- Rritja e qendrueshmërisë dhe parashikueshmërisë së kuadrit tatimor;
- Thjeshtimi dhe standardizimi i kuadrit tatimor, si dhe reduktimi i informalitetit;
- Përsheptimi i hapave për adoptimin e një Strategjie Afatmesme të të Ardhurave publike;
- Përmirësimi i strukturës së shpenzimeve, duke ruajtur një raport të drejtë midis shpenzimeve korrente e kapitale, duke u dhënë prioritet këtyre të fundit;
- Ruajtja e një balance korrente pozitive, për të rritur fleksibilitetin përballë goditjeve;
- Ruajtja e hapësirave aktuale për investime në strukturën e buxhetit;
- Kontrolli i shpenzimeve korrente, duke i rritur ato në linjë me përmirësimet strukturore në të ardhurat publike dhe luftën kundër informalitetit;
- Shpërndarja më e mirë e shpenzimeve gjatë vitit, duke ulur përqendrimin e tyre në tremujorin e katërt.

Së treti, rritja e qendrueshmërisë afatgjatë të financave publike.

Qendrueshmëria afatgjatë e financave publike shërben si garanci për ruajtjen e stabilitetit ekonomik e financiar të vendit. Banka e Shqipërisë vlerëson pozitivisht:

- Reduktimin e parashikuar në projektbuxhet për borxhin publik, nga 68.8 për qind e PBB në vitin 2022, në 67.5 për qind të PBB në vitin 2023;
- Adoptimin e dispozitës shtesë në ligjin organik të buxhetit, e cila kërkon ruajtjen e një balance primare pozitive në çdo vit fiskal, si garanci për reduktimin e qendrueshëm të borxhit publik.

Në përfundim, Guvernatori paraqiti disa rekomandime për përmirësimin e menaxhimit të skemave të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të programeve të partneritetit publik-privat.

V. Përmbajtja e projektligjit.

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2023” pasqyron një informacion të detajuar mbi treguesit kryesorë të buxhetit për vitin 2023, siç janë të ardhurat, shpenzimet, deficitin buxhetor dhe financimi i tij. Ky informacion paraqitet për buxhetin e shtetit, buxhetin vendor dhe fondet speciale. Gjithashtu, ai përcakton rregullat për përdorimin e fondeve buxhetore. Projektligji shoqërohet me një set tabelash, ku treguesit pasqyrohen në total dhe të detajuar sipas ministrive e institucioneve, programeve e zërave buxhetorë. Projektligji pasqyron edhe tavanet e shpenzimeve sipas institucioneve dhe programeve buxhetore për periudhën afatmesme 2023-2025.

Projektligji shoqërohet me relacionin shpjegues, ku analizohet në mënyrë të hollësishme realizimi i treguesve makroekonomikë e fiskalë për vitin 2022 dhe parashikimet për vitin 2023 e periudhën afatmesme 2023-2025. Raporti përmban edhe një analizë të hollësishme për buxhetin e njësisë të qeverisjes qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore, si dhe të fondeve speciale.

VI. Diskutimi në Komision.

Në mbledhjet e Komisionit paraqitën prezantime dhe iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve Ministrja e Financave dhe Ekonomisë dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Znj. Blerina Gjylameti dhe znj. Enslemvera Zake, relatore të projektligjit, paraqitën opinionin e tyre për projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm në tërësi, si dhe për pjesët e veçanta të tij: të ardhurat, shpenzimet, deficitin buxhetor dhe borxhin publik. Relatorët paraqitën edhe një opinion mbi zhvillimet ekonomike gjatë periudhës janar-shtator dhe pritshmëritë për vitin 2022, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e projektbuxhetit. Opinioni i relatoreve është si më poshtë:

VI.1. Zhvillimet ekonomike gjatë periudhës janar-shtator dhe pritshmëritë për vitin 2022.

Gjatë viteve 2020 dhe 2021 ekonomia e vendit u orientua drejt politikave dhe masave për përballimin e goditjeve të tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë shëndetësore COVID-19. Si rrjedhojë, treguesit makroekonomikë e fiskalë ishin më pozitivë se pritshmëritë fillestare. Pas recensionit të vitit 2020, viti 2021 pati një rikuperim dhe rritje të shpejtë të ekonomisë.

Gjatë periudhës janar-shtator 2022 ekonomia e vendit u përball me goditjen e tretë, sulmin e Ruisë ndaj Ukrainës, i cili megjithëse kishte ekspozim të kufizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj vendit tonë, solli si pasojë rritjen e çmimeve ndërkombëtare të energjisë dhe karburanteve, si dhe ngadalësimin ekonomik në Europë. Këto fenomene ndikuan negativisht në ekonominë e vendit, ndaj u ndërmorrën politika e masa për zbutjen e ndikimit të tyre.

Si rezultat i këtyre politikave, ecuria e ekonomisë ishte pozitive, me një rritje prej 4.2 për qind të PBB në 6-mujorin e parë të këtij viti, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Pritshmëritë janë që rritja ekonomike për vitin 2022 të jetë 3.7 për qind, nga 8.5 për qind një vit më parë. Rritja ekonomike në vendin tonë pritet të jetë mbi nivelin mesatar të pritshëm të vendeve të rajonit prej 3.1 për qind për vitin 2022.

Nga pikëpamja e kërkesës, rritja ekonomike u gjenerua kryesisht nga rritja e konsumit privat, investimeve dhe eksporteve. Rritja e konsumit u mbështet nga rritja e besimit të biznesit dhe konsumatorit, politikat mbështetëse fiskale e monetare, si dhe përmirësimi i ekonomive në vendet partnere.

Nga pikëpamja e ofertës, rritja ekonomike u arrit pothuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë, si në sektorët prodhues, ashtu edhe në ata të shërbimeve. Sektorët me rritje më të lartë ishin tregtia,

industria, bujqësia, ndërtimi, transporti, aktivitetet e pasurive të paluajshme, aktivitetet financiare dhe të sigurimit etj.

Edhe tregu i punës u karakterizua nga zhvillime pozitive. Shkalla e papunësisë në 6-mujorin e parë arriti 11.3 për qind, nga 12 për qind në vitin 2021. Numri i personave të punësuar në tremujorin e dytë u rrit me 4.3 për qind në krahasim me të njejtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tregtia e jashtme, për periudhën janar-gusht 2022, u karakterizua nga një rritje e ndjeshme prej 41 për qind e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe rritje me 25 për qind e importit. Si rrjedhojë, deficitin i llogarisë korrente u ngushtua me 10 pr qind. Rritja e numrit të vizitorëve të huaj ka sjellë rritjen e kërkesës në sektorin e turizmit, si dhe rritjen e të ardhurave nga ky sektor. Me rritje pozitive ishin edhe shërbimet, të cilat për 6-mujorin e parë u rritën me 65 për qind, si dhe remitancat me 11 për qind. Investimet e huaja direkte, për 6-mujorin e parë u rritën me 634 milionë euro ose 35 për qind.

Sektori financiar u karakterizua nga qendrueshmëria në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë. Kreditë me probleme vazhduan trendin rënës, duke arritur nivelin 5.3 për qind në muajin korrik, nga 8 për qind që ishin dy vjet më parë. Stoku i kredive bankare u rrit ndjeshëm, si për kreditë ndaj konsumatorëve, ashtu edhe për kreditë ndaj bizneseve. Edhe stoku depozitave u rritet ndjeshëm.

Inflacioni vazhdon të mbetet një sfidë kryesore për stabilitetin makroekonomik, rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike të vendit. Goditjet e ofertës dhe rritja e pasigurisë në tregjet botërore po transmetohen në rritje të inflacionit dhe ngadalësim të ritmit të rritjes ekonomike në vend. Megjithatë, inflacioni në vendin tonë, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, apo me mesataren e BE-së, ka qenë ndjeshëm më i ulët. Pritshmëritë janë që inflacioni mesatar për vitin 2022 të jetë 6.5 për qind, nga 2 për qind që ishte një vit më parë. Për vitin 2023 dhe periudhën afatmesme inflacioni parshikohet në rënie.

Kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave kryesore, në përgjithësi, ka qenë mjaft i qëndrueshëm, ndërkohë që luhatja (zhvlerësimi ose mbiçmimi) ndaj monedhave të ndryshme ka reflektuar kryesisht konjunkturën ndërkombëtare të tregut valutës. Aktualisht, leku është nënçmuar ndaj dollarit amerikan me rreth 8 për qind dhe është mbiçmuar ndaj euros me rreth 4 për qind që nga fundi i vitit të kaluar.

Politikat fiskale siguruan mbështetje për rimëkëmbjen ekonomike dhe forcimin e qëndrueshmërisë makroekonomike të vendit, e cila reflektohet nëpërmjet realizimit të treguesve kryesorë, si më poshtë:

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për periudhën 9-mujore, arritën nivelin 426 miliardë lekë, me një tejkalim prej rreth 2.8 miliardë lekësh ose 1 pikë përqindje në krahasim me planin. Në krahasim me të njejtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura u rritën me 58 miliardë lekë ose 15.8 pikë përqindje. Performanca pozitive e të ardhurave është ndikuar si nga rritja e çmimeve, ashtu edhe nga rritja ekonomike dhe përmirësimet administrative në mbledhjen e tyre.

Ecuria pozitive e të ardhurave pritet të vijojë edhe në muajt e mbetur të këtij viti. Parashikimet për vitin 2022 janë që të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të arrijnë nivelin 28.2 për qind të PBB, nga 27 për qind e PBB një vit më parë.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit arritën nivelin 411 miliardë lekë, me një realizim prej 93 për qind në krahasim me planin. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto shpenzime u rritën me rreth 7 miliardë lekë ose 1.7 pikë përqindje. Shpenzimet buxhetore janë rialokuar gjatë vitit me akte normative, për të siguruar mbështetjen e shtresave më të goditura nga kriza e rritjes së çmimeve. Masat kryesore që u ndërmorrën ishin:

- Alokimi i paketave të ndryshme të ndihmës ekonomike për pjesët e shoqërisë më në nevojë;
- Alokimi i fondeve për mbështetjen e sektorit energjetik, për të mbajtur të pandryshuar çmimin e energjisë elektrike si për konsumatorët familjarë, ashtu edhe për bizneset e vogla;
- Alokimi i fondeve për kompensimin pjesërisht të rritjeve në kostot kryesore për punimet e investimeve publike.

Suficiti buxhetor.

Deri tani, buxheti vijon të operojë me një suficit të përgjithshëm fiskal. Stoku i likuiditetit është mjaft i bollshëm dhe i mjaftueshëm për të vijuar ekzekutimin normal të buxhetit të këtij viti, si dhe të vitit të ardhshëm.

Suficiti buxhetor për periudhën 9 mujore të vitit 2022 rezultoi rreth 15 miliardë lekë, nga rreth 18 miliardë lekë deficit i planifikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku niveli i deficitit rezultonte në masën 36 miliardë lekë, për periudhën 9 mujore të vitit 2022 vihet re një rritje e ndjeshme e nivelit të suficitit.

Në rishikimin më të fundit të buxhetit, është ulur limiti ligjor i deficitit fiskal me gati 1 për qind të PBB-së: nga 5 për qind që ishte planifikuar fillimisht, është ulur në 4.1 për qind të PBB-së. Pritshmëritë janë që për vitin 2022 deficitit buxhetor të jetë rreth 3.3 për qind, pra më i ulët se buxheti i rishikuar.

Borxhi publik për vitin 2022 pritet të jetë rreth 68.8 për qind e PBB, nga 73.2 për qind e PBB një vit më parë.

VI.2. Karakteristikat kryesore të projektbuxhetit 2023 dhe të projektbuxhetit afatmesëm 2023-2025.

Treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë të projektbuxhetit 2023 janë si më poshtë:

- Rritja reale e PBB 2.6 %;
- Inflacioni 3.6 %;
- Të ardhurat 29 % e PBB;
- Shpenzimet 31.6 % e PBB;
- Defiçiti buxhetor - 2.6 % e PBB;
- Borxhi publik 67.5 % e PBB;
- Investimet publike 5.5 % e PBB;
- Norma e papunësisë 10.2 % e PBB.

Karakteristikat kryesore të projektbuxhetit 2023 dhe të projektbuxhetit afatmesëm 2023-2025 janë si më poshtë:

Së pari, rritja e ekonomisë me ritme pozitive.

Ekonomia e vendit parashikohet të zhvillohet me ritme pozitive gjatë vitit 2023 dhe periudhës afatmesme, megjithëse goditja globale nga kahu i ofertës për furnizimin me energji dhe mallra të tjerë bazë do të vazhdojë të ketë ndikim negativ. Ky ndikim është i pranishëm si në ekonominë tonë, ashtu edhe në vendet e rajonit, të Europës e më gjerë.

Si rezultat i kësaj goditjeje, ritmi i rritjes ekonomike në vitin 2023 parashikohet të ngadalësohet në 2.6 për qind, nga 3.7 për qind që pritet të jetë në vitin 2022. Për periudhën afatmesme, ritmi i rritjes ekonomike do të jetë i qëndrueshëm, rreth nivelit mesatar prej 3.7 për qind.

Kjo ecuri pritet të mbështetet nga rritja e kërkesës së brendshme, si nëpërmjet rritjes së konsumit privat, ashtu edhe të investimeve. Rritja e kërkesës së brendshme, veçanërisht e investimeve, do të reflektohet në rritjen e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht të turizmit, si dhe në rritjen e importeve.

Kontributi neto i kërkesës së huaj, në periudhën afatmesme, parashikohet të jetë pozitiv, por më i moderuar se ai i kërkesës së brendshme. Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, veçanërisht turizmi, pritet të kenë një ecuri të mirë. Importet pritet të rriten, por me ritëm më të ulët se eksportet. Rritja e importeve parashikohet të vijë nga rritja e kërkesës agregate, veçanërisht e investimeve.

Rritja ekonomike do vijojë të mbështetet nga stabiliteti i përgjithshëm, bilancet e shëndosha të familjeve dhe bizneseve, si dhe mbështetja me kredi nga sektori bankar. Ky sektor paraqitet i shëndetshëm, likuid dhe i mirëkapitalizuar. Reformat e vazhdueshme të ndërmarra vitet e fundit kanë dhënë frytet e veta. Konsolidimi i sektorit bankar, përmirësimi i ambientit të kredisë, zhvillimi i gjithanshëm i tregjeve financiare dhe i sistemeve të pagesave, si dhe nismat për nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare, kanë sjellë përmirësime të dukshme cilësore në qëndrueshmërinë dhe eficiencën e sektorit bankar.

Së dyti, rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Një ndër objektivat e projektbuxhetit 2023 është rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit, e cila përbën faktorin kyç për mbajtjen në kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2023, parashikohet të arrijnë nivelin rreth 632 miliardë lekë, duke u rritur me 55 miliardë lekë ose 10 pikë përqindje në krahasim me buxhetin e rishikuar për vitin 2022. Këto të ardhura parashikohen të jenë 29 për qind e PBB, nga 28.2 për qind e PBB të parashikuara në buxhetin e rishikuar për vitin 2022.

Rritja e të ardhurave parashikohet të vijë nga rritja reale e PBB, rritja e volumit të importeve, konjuktura e çmimeve ndërkombëtare, përmirësimi i administrimit fiskal dhe thellimi i luftës kundër informalitetit e evazionit fiskal.

Kontribut në rritjen e të ardhurave parashikohet të japin edhe ndryshimet e parashikuara në paketën fiskale 2023. Një politikë tjetër ndikuese është edhe rritja e pagës minimale nga 32 mijë lekë, në 34 mijë lekë. Rritja ekonomike pritet të sjellë rritje të pagës mesatare dhe rritje të numrit të të punësuarve në sektorin privat.

Rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit, sipas grupeve kryesore, parashikohet si më poshtë:

- Të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbëjnë rreth 68.3 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 36.2 miliardë lekë ose 9.2 pikë përqindje. Karakteristikë për vitin 2023 është rritja e peshës që zenë këto të ardhura ndaj të ardhurave të përgjithshme të buxhetit, në krahasim me një vit më parë.
- Të ardhurat nga fondet speciale përbëjnë rreth 20.2 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 9.9 miliardë lekë ose 8.5 pikë përqindje.
- Të ardhurat nga pushteti vendor përbëjnë rreth 4.6 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 1.5 miliardë lekë ose 5.5 pikë përqindje.
- Të ardhurat jotatimore përbëjnë rreth 3.6 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 0.3 miliardë lekë ose 1.1 pikë përqindje.
- Të ardhurat nga ndihmat përbëjnë rreth 3.3 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 7 miliardë lekë ose 49.8 pikë përqindje.

Së treti, rritja e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2023, parashikohen në nivelin 687 miliardë lekë, duke u rritur me 26.5 miliardë lekë ose 4 pikë përqindje. Këto shpenzime parashikohen të arrijnë nivelin 31.6 për qind të PBB.

Rritja e shpenzimeve sipas grupeve kryesore parashikohet si më poshtë:

- *Shpenzimet korrente* përbëjnë rreth 79.5 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime parashikohet të rriten me rreth 41.6 miliardë lekë ose 8.2 pikë përqindje.
- *Shpenzimet kapitale* përbëjnë rreth 17.8 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime parashikohen në vlerën 122.2 miliardë lekë, me një rritje prej 8.7 miliardë lekësh ose 5.6 pikë përqindje në krahasim me buxhetin e rishikuar për vitin 2022.

Shpenzimet kapitale parashikohen në nivelin 5.6 për qind të PBB, nga 5.5 për qind të PBB të parashikuara në buxhetin e rishikuar për vitin 2022.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale mbështetet në prioritetet e programit të qeverisë, prioritetet e integritetit europian dhe projektet në vazhdim.

Së katërti, vazhdimi i konsolidimit fiskal.

Objektivi themelor i politikës fiskale për vitin 2023 vazhdon të jetë konsolidimi fiskal, për të siguruar ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe rritjen ekonomike të qëndrueshme. Për këtë arsye:

- *Deficiti buxhetor* në vitin 2023 parashikohet 2.6 për qind e PBB, nga 4.1 për qind e PBB i parashikuar në buxhetin e rishikuar për vitin 2022;
- *Balanca primare* parashikohet të rikthehet në nivel pozitiv nga viti 2023 e në vijim (një vit më parë se parashikimi në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, ku është parashikuar rikthimi në nivel pozitiv nga viti 2024 e në vijim);
- *Balanca korrente fiskale* do të jetë pozitive në vitin 2023, në nivelin 2.9 për qind të PBB, nga një nivel i pritshëm pozitiv prej 2.2 për qind për vitin 2022. Ky parashikim është në përputhje me rregullin e artë të buxhetit dhe mundëson që borxhi publik të merret vetëm për të financuar investimet publike.
- *Borxhi publik* parashikohet në nivelin 67.5 për qind të PBB, nga 68.8 për qind e PBB i pritshëm për vitin 2022. Borxhi publik parashikohet të vijojë trajektoren rënëse nga viti në vit, në përputhje me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, duke arritur nivelin 64.4 për qind të PBB në vitin 2026 dhe 55 për qind të PBB në vitin 2031.

Së pesti, rritja e mbështetjes financiare të punonjësve në disa sektorë prioritarë.

Projektbuxheti i vitit 2023 reflekton politikat për:

- Rritjen me 6 për qind të pagave për sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes, me një fond prej 2.3 miliardë lekësh, politikë e nisur më 1 korrik 2022;
- Rritjen me 7 për qind të pagave për administratën publike (nisur më 1 shtator 2022). Fondi për këtë qëllim është rreth 97 miliardë lekë ose 4.5 për qind e PBB;
- Parashikimin e një fondi prej 1.2 miliardë lekësh për indeksimin e pensioneve dhe 3.5 miliardë lekësh për bonusin e fundvitit për pensionistët.

Së gjashti, buxheti i vitit 2023 do të vazhdojë mbështetjen e shtresave sociale në nevojë, duke parashikuar:

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë në vlerën 900 milionë lekë;
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në vlerën 26 miliardë lekë ose 1.2 për qind e PBB;
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekësh ose 0.1 për qind e PBB;
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2.2 miliardë lekësh ose 0.1 për qind e PBB.

Së shtati, reforma e decentralizimit të qeverisjes do të vijojë me përparësi edhe gjatë vitit 2023 dhe periudhës afatmesme, duke synuar përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Shpenzimet për buxhetin vendor, në vitin 2023, parashikohet të jenë 65.5 miliardë lekë, me një rritje prej 5.3 miliardë lekësh ose 8.8 pikë përqindje. Bazë për këtë rritje do të shërbejnë, kryesisht:

- Rritja e transfertës së pakushtëzuar të buxhetit të shtetit për pushtetin vendor me 3.6 miliardë lekë ose 12.7 pikë përqindje;
- Përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave nga qeverisja vendore, të cilat parashikohen të rriten me 1.5 miliardë lekë ose 5.5 pikë përqindje në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2022.

Së fundi, në projektbuxhetin e vitit 2023 parashikohen edhe rreziqet fiskale dhe masat mbrojtëse përkatëse.

Një ndër risqet e mundshme është tejkalimi i vlerës ligjore të kontratave të koncesionit/PPP. Projektbuxheti i vitit 2023 respekton rregullin e përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, sipas të cilit:

“Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo të partneritetit publik privat, si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.”

- Të ardhurat tatimore faktike të pritshme, për vitin 2022, janë rreth 544.2 miliardë lekë. Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5 për qind të të ardhurave tatimore të pritshme, për vitin 2022, është rreth 27.2 miliardë lekë;
- Totali i pagesave vjetore neto që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat e koncesionit/PPP, është rreth 13.5 miliardë lekë. Këto pagesa përbëjnë vetëm 2.5 për qind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të pritshme për vitin 2022.

* * *

Shumica e anëtarëve të Komisionit mbështetën vlerësimin e bërë nga relatorët për realizimin e buxhetit të vitit aktual, projektbuxhetin vjetor e afatmesëm, si dhe politikat respektive.

Deputetët e opozitës u shprehën kundër projektligjit “Për buxhetin e vitit 2023”.

Disa anëtarë të Komisionit kërkuan informacione shtesë dhe i drejtuan pyetje titullarëve të institucioneve të pranishme në mbledhje.

Çështjet kryesore të diskutuara në Komision dhe informacioni shtesë respektiv, i paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, janë si më poshtë:

Së pari, lidhur me arsyet e mosrealizimit të plotë të planit të shpenzimeve kapitale për periudhën 9-mujore të vitit 2022 dhe parashikimet për periudhën e mbetur të vitit:

Shpenzimet kapitale, për periudhën 9 mujore të vitit 2022, arritën nivelin rreth 50.7 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 81.1 për qind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në mosrealizimin e plotë të planit të shpenzimeve kapitale lidhen me:

- Ngadalësimin e investimeve publike në 6-mujorin e parë të vitit, si rezultat i rritjes së lartë dhe të menjëhershme të çmimit të hekurit, çimentos dhe disa materialeve të tjera të ndërtimit. Shumë kompani u gjendën përballë faktit që, me kontratat publike të miratuara,

mund të shkonin drejt humbjeve financiare, duke rezikuar punësimin dhe të ardhmen e kompanive. Për këtë qëllim, në qershor të këtij viti u miratua edhe një akt normativ, që synoi zhbllokimin e situatës.

- Procedurat e ngadalta të prokurimeve, që në shumicën e rasteve shkojnë drejt ankimimeve.

Me analizat dhe rialokimet e kryera, Ministria e Financave dhe Ekonomisë parashikon një nivel të lartë realizimi të shpenzimeve kapitale deri në fund të vitit.

Së dyti, lidhur me pretendimin se vlera e kontratave të koncesionit/PPP në projektbuxhet është e lartë dhe sjell risqe për ekonominë e vendit:

Vlera e kontratave të koncesionit/PPP në projektbuxhet plotëson rregullat fiskalë, të parashikuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, si më poshtë:

Rregulli fiskal i parë.

Në projektbuxhetin për vitin 2023 respektohet rregulli fiskal i sanksionuar në nenin 4/2 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”:

“Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.”.

Aktualisht, janë aktive 11 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP).

- Për vitin 2023, kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5 për qind i të ardhurave tatimore të pritshme të vitit 2022, është rreth 27.2 miliardë lekë. Për vitin 2023 pagesat vjetore neto që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare apo PPP, arrijnë vlerën rreth 13.5 miliardë lekë.
- Rrjedhimisht, në buxhetin 2023 respektohet kufizimi ligjor i sipërcituar, pasi vlera e parashikuar prej rreth 13.5 miliardë lekë për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare apo PPP për vitin 2023, përbën vetëm 2.5 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të pritshme për vitin 2022, prej rreth 544.2 miliardë lekësh.

Edhe për periudhën 2024-2025, rregulli fiskal respektohet në mënyrë rigorozë, pasi pagesat buxhetore për këto kontrata aktive nuk e tejkalojnë nivelin prej 2.6 për qind të totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës.

Vlen të theksohet këtu, se impakti i pagesave buxhetore për kontratat koncesionare/PPP ka ardhur në rënie përgjatë 4 viteve të fundit, nga 3.3 për qind të observuar në vitin 2019, në 2.7 për qind që parashikohet të arrihet në fund të vitit 2022.

Rregulli fiskal i dytë.

Ky rregull sanksionohet në nenin 4/2 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar:

“Kuvendi, në ligjin vjetor të buxhetit, miraton tavanin e vlerës totale të kontratave në përqindje të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi gjatë vitit buxhetor korrent.”.

Në nenin 18 të projektligjit për buxhetin e vitit 2023 përcaktohet se:

“Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së, për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2022, në përputhje me të dhënat e regjistrimit të koncesioneve, është 35.9 për qind e PBB-së. Çdo kontratë e re ndjek procedurat dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP-të.”.

Vlera prej 35.9 për qind e PBB, e parashikuar për vitin 2023, është rreth 6 për qind më e vogël se vlera e përlogaritur në projektbuxhetin e vitit 2022 (41.9 për qind e PBB). Kjo vjen kryesisht si pasojë e rritjes së nivelit të PBB nominale për vitin 2023, si dhe rishikimeve të mëposhtme:

1. Projekti “Dhënia me koncesion e një segmenti rrugor Milot-Fier në Autostradën Adriatiko-Joniane”, me vlerë 146,1 miliardë lekë i parashikuar në projektbuxhetin 2022, është zëvendësuar me 3 projekte të reja PPP me vlerë totale (pa TVSH) prej 100.1 miliardë lekësh, të detajuar si më poshtë:
 - a) “Për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot-Thumanë” (pa TVSH) me vlerë 5.3 miliardë lekë;
 - b) “Për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Kashar-Lekaj” (pa TVSH) me vlerë 56.8 miliardë lekë;
 - c) “Për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Lekaj-Fier” (pa TVSH) me vlerë rreth 38 miliardë lekë.

2. Janë hequr nga lista e PPP të planifikuara për vitin 2023 projektet PPP si më poshtë:
 - a) Për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe rekreative të blloqeve të banimit në disa lagje të qytetit Elbasan me vlerë 882 milionë lekë;
 - b) Rritja e Sigurisë Rrugore me vlerë 5 miliardë lekë.

Këto projekte janë hequr, pasi nuk u konfirmuan nga ministritë respektive dhe ATRAKO.

Së treti, lidhur me detyrimet e prapambetura:

Bazuar në VKM nr.50 datë 5.2.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura. Vlen për t’u theksuar se tashmë monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore.

Duke nisur nga muaji dhjetor 2020, ky monitorim dhe raportim, i cili më parë kryhej mbi bazë tremujore, nëpërmjet raportimit shkresor të institucioneve, tashmë gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.37, datë 6.10.2020. Ky format i raportimit të detyrimeve të prapambetura, përveç se rrit saktësinë dhe siguron të dhënat në kohë, është gjithashtu një format gjithëpërfshirës, duke unifikuar raportin për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Deri në fund të muajit Qershor 2022 regjistrohet një stok kumulativ prej 15.45 miliardë lekësh detyrime të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

- Totali i detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 7.91 miliardë lekë;
- Totali i detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së rreth 0.48 miliard lekë;
- Totali i detyrimeve të qeverisë vendore rreth 7.06 miliard lekë.

Krahasuar me stokun e detyrimeve të raportuara për 6-mujorin e vitit 2021, rezulton që:

- Niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 2.64 miliardë lekë më i ulët;
- Megjithëse kemi një rritje prej rreth 422 milionë lekë të detyrimeve të njërive të qeverisjes vendore, detyrimet për rimbursimin e TVSH-së janë ulur ndjeshëm me rreth 1.25 miliardë lekë në 6-mujorin e parë të vitit 2022, krahasuar me 6-mujorin e parë 2021.

Krahasuar me stokun e detyrimeve të raportuara për 3-mujorin e vitit 2022, rezulton që:

- Niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 0.91 miliardë lekë më i lartë. Konkretisht, totali i detyrimeve të njërive të qeverisjes qendrore është rritur me rreth 1.15 miliardë lekë, ndërsa totali i detyrimeve të njërive të qeverisjes vendore është ulur me rreth 0.24 miliardë lekë. Detyrimet për rimbursimin e TVSH-së janë në të njëjtën vlerë me tremujorin e parë të vitit 2022, në nivelin 0.48 miliardë lekë .

Zërat që kanë patur rritje (për detyrimet qendrore) në krahasim me 3-mujorin 2022 janë investimet dhe vendimet gjyqësore. Një nga arsytet e kësaj rritje është edhe efekti i implementimit të plotë të udhëzimit nr.37, datë 6.10.2.2020, që ndryshoi metodologjinë e ndjekur në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave lidhur me detyrimet e prapambetura, përmes Modullit përkatës të Thesarit të ndërtuar për këtë qëllim.

Stoku i detyrimeve të prapambetura, vitet e fundit, ka ndjekur një tendencë në rënie progresive. Megjithatë, prioriteti kryesor në periudhën afatmesme mbetet ende pastrimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre. Kështu, ka lindur nevoja për të vendosur një objektiv specifik ndër vite, duke pasur parasysh trendin historik të stokut të detyrimeve të prapambetura.

Këto objektiva, që përgjithësisht kanë çuar në një reduktim të detyrimeve të prapambetura, janë arritur në vite të veçanta, dhe janë specifikuar në vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare, si:

- *Vlerësimi PEFA (A score).*

Stoku i detyrimeve të prapambetura nuk kalon 2 për qind të totalit të shpenzimeve në të paktën dy nga tre vitet e fundit fiskalë.

- *Good Governance Indikatori 3*

- ✓ Detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin 2021 rezultojnë nën 3 për qind (Objektivi për Vitin 2021 është përmbushur).
- ✓ Detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin 2022 rezultojnë nën 2.5% (Pritshmëritë tona për përmbushjen e këtij objektivi janë pozitive).

Për vitin 2022, efektet e krizës globale të energjisë, lufta në Ukrainë, rritja e kostove të mallrave të konsumit, kanë çuar në një rritje të lehtë të stokut të detyrimeve të prapambetura në nivel të përgjithshëm. Specifikat që do të karakterizojnë luhatjen e çmimeve të energjisë, karburanteve dhe inputeve, do të ndikojnë në "sjelljen" që do të kenë detyrimet e prapambetura për pjesën tjetër të vitit 2022.

Megjithatë, duhet theksuar se në fund të vitit fiskal, zakonisht, realizohet rishikimi përfundimtar i ligjit të buxhetit. Ky rishikim përfundimtar, tradicionalisht, konsiston në rialokime buxhetore midis programeve, kryesisht në projekte të shpenzimeve kapitale, me qëllim që qeveria të arrijë pastrimin e një pjese të madhe të stokut të detyrimeve të prapambetura. Akti Normativ i fundit të vitit 2021 është një dëshmi e qartë e kësaj situate.

VII. Rekomandime.

Relatoret paraqitën disa rekomandime për përmirësimin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit, si dhe të zhvillimit ekonomik të vendit. Këto rekomandime u mbështetën nga shumica e anëtarëve të Komisionit dhe janë si më poshtë:

1. Reformat strukturore, që nxisin rritjen e qëndrueshme të ekonomisë, duhet të vazhdojnë e të thellohen më tej. Këto reforma duhet të orientohen drejt rritjes së nivelit të konkurrencës

në treg, heqjes së barrierave ndaj biznesit, nxitjes së investimeve të huaja, rritjes së pjesëmarrjes së grave në forcën e punës, përmirësimit të cilësisë së arsimit, rritjes së standardeve të qeverisjes, përfshirë dixhitalizimin etj.

2. Rritja e të ardhurave buxhetore mbetet prioritet i politikës fiskale, për shkak të mundësive që krijon për zhvillimin ekonomik të vendit dhe uljen e borxhit publik. Administratat tatimore e doganore duhet të forcojnë punën për zbatimin e legjislacionit aktual dhe përmirësimin e mëtejshëm të tij, përmirësimin e administrimit fiskal, si dhe reduktimin e informalitetit dhe evazionit fiskal. Legjislacioni fiskal duhet të përmirësohet në drejtim të kufizimit të përjashtimeve nga tatimet e taksat, rishikimit të normave të reduktuara, thjeshtimit dhe lehtësimit të procedurave, zgjerimit të bazës tatimore etj. Në këtë kuadër, rëndësi të veçantë merr hartimi dhe vënia në zbatim, sa më parë, e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, e cila pritet të ndikojë në reformimin e sistemit tatimor në vendin tonë.
3. Konsolidimi fiskal është një politikë që duhet të vazhdojë, për të reduktuar nga viti në vit borxhin publik dhe për të lehtësuar brezat e sotëm e të ardhshëm.
4. Përmirësimi i transparencës dhe cilësisë së investimeve publike, si dhe rritja e efektivitetit të tyre përbën një detyrim shumë të rëndësishëm për të gjitha ministritë dhe institucionet buxhetore. Ministritë dhe institucionet duhet të përmirësojnë më tej menaxhimin e fondeve buxhetore me financim nga brenda ose jashtë vendit.
5. Politika monetare duhet të vazhdojë të ketë prioritet çuarjen e inflacionit drejt objektivit dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit. Harmonizimi i saj me politikën fiskale përbën një detyrim të rëndësishëm, për të nxitur veprimtarinë e biznesit dhe zhvillimin e ekonomisë.
6. Mbështetja e shtresave në nevojë duhet të jetë në fokus të vazhdueshëm, për të zbutur ndikimin e rritjes së inflacionit dhe për të nxitur konsumin. Kjo mbështetje duhet të jetë e studiuar, e përligjur, me përfitues të identifikuar, si dhe objekt i transparencës dhe llogaridhënies.
7. Reformat në klimën e biznesit duhet të vazhdojnë, për të mbështetur rritjen e investimeve private dhe të punësimit.
8. Në sektorin e energjisë elektrike duhet të vijnë masat për maksimizimin e përdorimit të burimeve ujore me impiantet ekzistuese, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjet, ndjekjen dinamike të konjunkturave të tregut ndërkombëtar të energjisë, me qëllim maksimizimin e bilancit blerje-shitje të energjisë, si dhe gjetjen e burimeve financiare për shtimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë së pastër (nga burimet ujore, era dhe impiantet voltaike). Shoqëritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë

elektrike duhet të tregojnë më shumë kujdes në menaxhimin dhe shëndoshjen e situatës financiare.

9. Sfidë për periudhën e ardhshme mbetet edhe përmirësimi i menaxhimit të koncesioneve dhe partneriteteve publike private. Duhet të forcohet më tej kapaciteti i administratës publike, si një barrierë proaktive në përzgjedhjen e projekteve, vlerësimin dhe monitorimin e tyre.

VIII. Përfundim.

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2023”:

- Është në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Ka ardhur dhe shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;
- Sjell përmirësime në treguesit makroekonomikë dhe zhvillimin ekonomik të vendit;

Për këtë arsye, Komisioni e miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023” me shumicën e deputetëve të pranishëm në mbledhje. Deputetët e opozitës votuan kundër projektligjit në parim.

RELATORET

Blerina GJYLAMETI

Enslemvera ZAKE

KRYETARI

Eduard SHALSI